Komunikata

22/04/2026

Raporti I Ngjarjeve, 22 Prill 2026

Lushnjë / Informacion paraprak

Rreth orës 18.25, në aksin rrugor "Lushnjë–Fier", shtetasi Z. H., 50 vjeç, duke drejtuar automjetin, është përfshirë në një aksident rrugor me një motomjet, me drejtues shtetasin A. T., 28 vjeç.

Si pasojë e aksidentit është dëmtuar drejtuesi i motomjetit, shtetasi A. T., i cili ndodhet në spital për ndihmë mjekësore, në gjendje të rëndë shëndetësore.

Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për sqarimin e plotë të rrethanave të aksidentit.

Shkodër / Informacion paraprak

Rreth orës 18.05, në aksin rrugor "Velipojë–Shkodër", automjeti me drejtues shtetasin A. A. është përplasur me automjetin me drejtues shtetasin I. L.

Si pasojë e aksidentit, janë dëmtuar lehtë pasagjerët në të dy automjetet, shtetasit F. A., A. Xh. dhe T. M., të cilat ndodhen në Spitalin Rajonal Shkodër, jashtë rrezikut për jetën.

Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, po punon për sqarimin e rrethanave të aksidentit.

Kurbin/Informacion paraprak

Rreth orës 18.55, në afërsi të hyrjes së qytetit të Laçit, në rrethana ende të paqarta, është qëlluar me armë zjarri në drejtim të automjetit me të cilin lëvizte shtetasi M. N.
Nga të shtënat nuk ka shtetas të dëmtuar.

Nga veprimet e shpejta janë identifikuar autorët e dyshuar: shtetasi P. Gj. dhe dy djemtë e tij, shtetasit H. Gj. dhe P. Gj. (njëri prej tyre dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të automjetit), ndërsa vijojnë kontrollet për kapjen e tyre.

Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për sqarimin e rrethanave të rastit dhe dokumentimin e plotë të rastit.

Memaliaj

Zbardhen rrethanat e ngjarjes, ndodhur mbrëmjen e datës 21.04.2026, në Memaliaj, ku u vra me armë zjarri shtetasi E. G. dhe mbeti i plagosur shtetasi D. N.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve të Rënda të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, nën drejtimin e Prokurorisë Gjirokastër, vijuan hetimet e thelluara me qëllim zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes, ndodhur mbrëmë, në Memaliaj.

Si rezultat i hetimeve, u vunë në pranga shtetasit:

D. N., 25 vjeç dhe A. K., 47 vjeç, të dy banues në Memaliaj, për veprat penale "Vrasja me dashje", kryer në bashkëpunim, dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit";

E. M., 41 vjeç, banues në Memaliaj, për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës".

Si dhe u shpallën në kërkim shtetasit D. N., 29 vjeç dhe vëllai i tij, shtetasi M. N., 28 vjeç, të dy për veprat penale "Vrasja me dashje", kryer në bashkëpunim, dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

Gjithashtu, nisi procedimi penal për shtetasin J. K., 44 vjeç, banues në Memaliaj, për veprën penale "Deklarataat e reme përpara prokurorit", si dhe për shtetasin G. Q., 49 vjeç, banues në Memaliaj, për veprën penale "Kanosja".

Nga veprimet hetimore ka rezultuar se mbrëmë ka patur një konflikt fizik të çastit, në të cilin janë përfshirë shtetasit D. N., M. N., D. N., A. K. dhe J. K., si dhe shtetasit G. Q. dhe E. G.

Gjatë konfliktit, dyshohet se shtetasi E. G. ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtetasit D. N. (i arrestuar tashmë), i cili mbeti i plagosur dhe vjon të jetë në kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën.

Më pas, 2 vëllezërit e shtetasit D. N. (2 shtetasit e shpallur në kërkim, D. N., 29 vjeç dhe M. N., 28 vjeç), dyshohet se kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtetasit E. G. (i cili, si pasojë, ka humbur jetën gjatë transportimit në spital).

Të dy këta shtetasa janë larguar menjëherë me automjet nga vendi i ngjarjes, ndërsa vijon puna intensive për kapjen e tyre.

Sekuestrohen në cilësinë e provës materiale: arma e zjarrit pistoletë (me fishek në fole, gati për qitje), me të cilën dyshohet se shtetasi E. G. (i cili më pas humbi jetën) plagosi shtetasin D. N., 1 krehër me fishekë, municion luftarak, 2 automjete, 2 motomjete, 4 celularë dhe sende të tjera nga vendngjarja, të cilat do t'i shërbejnë vijimit të hetimit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Gjirokastrës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Durrës

Specialistët e qarkullimit rrugor arrestuan në flagrancë shtetasen D. D., 22 vjeçe, banuese në Kavajë, pasi dje, në Golem, duke drejtuar automjetin, dyshohet se ka humbur kontrollin dhe për pasojë ka aksidentuar shtetasin R. L., 28 vjeç, këmbësor, i cili po mer ndihmë mjekësore në spital.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Durrës referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin J. Xh., 39 vjeç, pasi është konstatuar duke kryer punime ndërtimi, pa leje.
Gjithashtu, referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasin Italian M. F., 53 vjeç, banues në Durrës, për veprën penale "Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve", pasi dyshohet se ka mbajtur të mbyllur në një banesë me qira, në lagjen nr. 15, disa kafshë shtëpiake(këlysha qeni), në kushte të papërshtatshme. Punohet për kapjen e tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Stacionit të Policisë Plazh referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasen M. M., pasi ka kryer punime ndërtimi, në kundërshtim me vendimin e autoriteteve kompetente që kanë përcaktuar pezullimin e këtyre punimeve.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Kavajë referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasin Xh. H., 46 vjeç, banues në fshatin Bago, Kavajë, pasi ka kryer punime ndërtimi, pa leje. Punohet për kapjen e tij.
Gjithashtu, u referuan materialet në Prokurori, për rastet në vijim:
-në lagjen nr. 4, Kavajë, në berberhanën në pronësi të shtetasit E. B., dyshohet se është vjedhur një shumë parash;
-në Helmas, Kavajë, në marketin e shtetasit P. L., dyshohet se janë vjedhur disa steka me cigare;
-në banesën e shtetasit H. D., në Kavajë, dyshohet se është vjedhur një shumë parash.
Punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve të këtyre rasteve.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Durrës referuan materialet në Prokurori, për vlerësim, pasi kallëzoi shtetasi F. M., në është larguar nga banesa, gjysha e tij, shtetasja F. M., 71 vjeçe, banuese në Durrës. Punohet për gjetjen e saj.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Shijak referuan materialet në Prokurori, për vlerësim, pasi dje, është dërguar në spital, një fëmijë 5 vjeç, i cili dyshohet se është djegur aksidentalisht me ushqim të nxehtë. I mituri vijon të jetë në kujdesin e mjekëve, në gjendje jashtë rrezikut për jetën.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan

Në lidhje me një postim në rrjete sociale, sipas të cilit në afërsi të një lokali në Librazhd është qëlluar me armë zjarri një kafshë (qen), bëjmë me dije se specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Librazhd kanë kryer veprimet e para hetimore. Deri më tani nuk janë konstatuar prova për një ngjarje të tillë dhe, nga deklarimet e marra nga disa persona, rezulton se ata nuk kanë dijeni për këtë rast. Ndërkohë vijojnë veprimet për sqarimin e plotë të këtij rasti.

Materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë për vlerësim të mëtejshëm.

-Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Peqin referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin K. Ç., 38 vjeç, pasi dyshohet se ka kanosur ndërmjet thirjeve/mesazheve telefonike, një 23-vjeçar.

-Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Librazhd referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për 2 shtetas të moshave 16 dhe 17 vjeç, pasi dyshohet se i kanë vjedhur portofolin, një 16-vjeçari.

-Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Gramsh referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin R. M., 66 vjeç, pasi dyshohet se si pasojë e batimit aksidental të njëjtit të punës (vinç) që drejtonte, është derdhur sasi vaj industrial që ka dëmtuar një sipërfaqe toke (pronë private) në fshatin Cerujë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Elbasanit, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Korçë:
-arrestuan në flagrancë shtetasen E. A., 48 vjeç, banues në Korçë, pasi është kapur jashtë banesës së tij, nga e cila ka dalë në kundërshtim me vendimin e Gjykatës, që i kishte caktuar masën e sigurisë "Arrest në shtëpi", për veprat penale "Drejtimi i automjetevee në mënyrë të parregullt", "Largimi nga vendi i aksidentit" dhe "Shkatërrimi i pronës".
-referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasen T. J., 60 vjeçe, banuese në fshatin Kamenicë, Korçë, pasi dyshohet se ka kanosur me fjalë një 43-vjeçare.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Pogradec:
-referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin I. Xh., 55 vjeç, banues në Pogradec, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj vëllait të tij, i cili u pajis me urdhër mbrojtjeje;
-referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin I. B., 42 vjeç, banues në fshatin Slabinjë, Pogradec, pasi është konstatuar nga një gazetar investigativ, duke transportuar me kamion, një sasi drush pa dokumentacionin përkatës. Lënda drusore dre mjeti u sekuestruan në cilësinë e provës materiale;
-referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasen D. L., 48 vjeçe, banuese në Pogradec, pasi dyshohet se ka përndjekur një 38-vjeçare.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasit K. M., 33 vjeç (agjent shitjesh në një kompani elektroshtëpiakesh) dhe S. M., 34 vjeç, banues në Tiranë, (administrator i kompanisë). 33-vjeçari i ka shitur një shtetasesje në Korçë, mëpërmjet mashtrimit, një pajisje elektroshtëpiake. Nga verifikimet rezultoi se shtetasi K. M., punonjësi i subjektit, ishte i pasigurtuar dhe i padeklaruar në organet tatimore. Gjithashtu, gjatë kontrollit në një automjet të kompanisë, u gjetën pajisje të tjera elektroshtëpiake, pa dokumentacionin shoqërues, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, së bashku me mjetin.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Devoll referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasit A. K., 65 vjeç dhe E. Xh., 60 vjeç, banues në fshatin Braçanj, Devoll, pasi në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë prenë pemë, pa leje, në një sipërfaqe pyjore të fshatit. Pemët e prera u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Korçës, për veprime të mëtejshme.

Maliq/Më datë 21.04.2026, në spitalin e Korçës, është dërguar nga familjarët, një 7-vjeçar, banues në fshatin Shëngjergj, Maliq. Nga verifikimet e kryera dhe deklarimet e familjarëve të tij, rezulton se i mituri ishte dëmtuar pasi ishte mëzuar aksidentalisht duke luajtur. Aktualisht ai është në kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën.

Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Vlorë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit: S. L., 24 vjeç dhe S. L., 18 vjeç (vëllezër), M. V., 18 vjeç, E. K., 18 vjeç, K. S., 18 vjeç, si dhe për 4 shtetas të mitur (tre prej tyre 17 vjeç, njëri 16 vjeç), të gjithë banues në Vlorë, pasi dyshohet se pasdithen e djeshme, në lagjen "Lef Sallata", janë konfliktuar fizikisht dhe me sende të forta, me njëri-tjetrin, për motive të dobëta.
Si pasojë janë dëmtuar lehtë 4 nga shtetasit e përfshirë në konflikt, të cilët morën ndihmën e nevojshme mjekësore në spital dhe janë jashtë rrezikut për jetën.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. A., 71 vjeç, banues në Sarandë, pasi ka kallëzuar shtetasi V. Th., banues në Delvinë, se shtetasi A. A. i ka pushtuar tokën në fshatin Gjashtë, Sarandë, mëpërmjet mashtrimit.
Gjithashtu, këta specialistët referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin K. M., 33 vjeç, banues në Vlorë, pasi ka kryer punime ndërtimi, pa leje.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Himarë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin P. Z., 60 vjeç, banues në Vlorë, pasi ka kallëzuar shtetasi T. Z., me vetëgyejsi, ka rrethuar tokën që ata kanë në bashkëpronësi, në Himarë.

Specialistët e Seksionit të Trafikut Urban dhe Interurban të DVP Vlorë referuan materialet në Prokurori, pasi ka kallëzuar shtetasi I. N., 26 vjeç, banues në Vlorë, se dje, në lagjen "Uji i Fshtë", automjeti që ai drejtonte është përplasur nga një automjet tjetër, i cili më pas ka përplasur edhe një automjet të parkuar. Drejtuesi i automjetit që ka shkaktuar aksidentin është larguar. Po punohet për identifikimin dhe kapjen e tij.

Materialet procedurale iu referuan prokurorive kompetente, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasen E. H., pasi dyshohet se mëpërmjet mashtrimit, i ka marrë një shumë parash, shtetasES E. B.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin K. T., pasi dyshohet se ka kanosur shtetasin E. T.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 3:
-arrestuan shtetasit L. Rr., 32 vjeç dhe D. Rr., 35 vjeç, si dhe referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për 4 të mitur, pasi dyshohet se për motive të dobëta, 6 shtetasit janë konfliktuar fizikisht, me njëri-tjetrin;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për një 18-vjeçar pasi posedonte një armë të fshehë (thikë), e cila u sekuestrua me cilësinë e provës materiale;
-shpallën në kërkim shtetasin E. C., pasi dyshohet se ka kanosur një shtetase. Punohet për kapjen e tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4 vunë në pranga shtetasin M. Gj., 29 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së tij. Gjithashtu u konstatua se 29-vjeçari posedonte sasi lënde narkotike Cannabis Sativa, e cila u sekuestrua me cilësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 5 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin S. P., pasi u kap duke hedhur inerte dhe dhera, në një sipërfaqe toke, dyshohet në kundërshtim me ligjin.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 6:
-arrestuan shtetasin A. M., 32 vjeç, pasi u kap duke hedhur lëndë piroteknike. Më tej, gjatë shoqërimit në ambientet e Policisë, 32-vjeçari ka goditur efektivët;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetaset Zh. M. dhe B. T., pasi dyshohet se janë konfliktuar fizikisht, me njëra-tjetrën.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 7 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin E. S., pasi dyshohet se ka kanosur shtetasin E. D.

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent